



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Adresa: Kontrolli i Lartë i Shtetit Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr.1343/12Prot.

Tiranë, më 26/06/2018

V E N D I M

Nr.57, Datë 26.06.2018

P Ë R

AUDITIMIN E USHTRUAR NË FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE E RREGULLSHMËRIE MBI PROJEKTIN “ZHVILLIMI I ALPEVE SHQIPTARE DHE ZONAVE BREGDETARE”, PËR PERIUDHËN PREJ FILLIMIT DERI NE 31.12.2017.

Nga auditimi i ushtruar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për projektin për projektin “**Zhvillimi i alpeve shqiptare dhe zonave bregdetare**”, të financuar me huanë e Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, (CEB) rezultoi se në përgjithësi është zbatuar ligji nr. 69/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër të financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës për punët e Komunitetit IV, të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, projekti “Zhvillimi i alpeve shqiptare dhe zonave bregdetare”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit IT^{së} dhe Financimeve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të përputhshmërisë e rregullshmërisë për projektin “Zhvillimi i alpeve shqiptare dhe zonave bregdetare”, sipas programit të auditimit nr.1343/2/2, datë 11.01.2017, për veprimtarinë prej fillimit të projektit deri më datën 30.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

OPINIONI I AUDITIMIT:

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë janë ISSAI 4100 dhe 4200¹, ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti – Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatuan devijime materiale në:

Procedurat e prokurimit për shërbime konsulence, specifikisht ato me objekt “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Vlorës”, “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Himarës”, “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në fshatrat e Dhërmiut dhe Vunoit, Bashkia Himarë” dhe “Shërbime projektimi për rigjenerimin urban të zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë” nuk kanë reflektuar parimet e menaxhimit të ciklit të projektit dhe nuk kanë trajtuar të gjitha çështjet për arritjen e objektivave dhe qëndrueshmërisë së projektit.

Janë zgjedhur procedura prokurimi që kanë limituar pjesëmarrjen dhe kontratat janë fituar nga disa konsulentë të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor nëpërmjet negociimit. Në këto procedura ka patur shkelje të Udhëzuesit të Prokurimit të CEB -Shtator 2011, në lidhje me përgjegjshmërinë, devijimet materialet dhe rezervat ndaj termave, kushteve dhe specifikimeve në dokumentet e tenderit.

Përsa i përket shërbimeve të kryera nga projektuesit, në të gjithë rastet konstatohen shtesa artificiale në preventivat e punimeve. Duke konsideruar se këto preventivë kanë shërbyer për përcaktimin e fondit limit të kontratave të zbatimit të punimeve, këto shtesa pikësëpari kanë favorizuar subjektet ndërtues duke u dhënë mundësinë e përfitimit të padrejtë të fondeve publike. Pikësëdyti shtesat artificiale në preventiv janë bërë qëllimisht për përfitim të padrejtë të fondeve publike nga ana e projektuesve pasi, tarifat e tyre të projektimit llogariten si përqindje e vlerës së punimeve. Përsa i përket punimeve të kryera në kuadër të të projektit LD 1853 (2014) “Punët e Komunitetit IV”, konstatohet se nga FSHZH në cilësinë e zhvilluesit të projekteve, në kundërshtim të plotë me ligjin për gjashtë proejkte janë prokuruar dhe kryer punime pa kryer oponentë teknike si dhe pa leje ndërtimi. Projekti është në proces zhvillimi, dhe deri në datën e kryerjes së auditimit është likuiduar rreth 35 % e tij.

Opinion i pakualifikuar:

¹ *ISSAI 4000 – Objektiv i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me pasqyrave financiare çështje të veçanta.*

Nga auditimi i ligjshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Fondi Shqiptar i zhvillimit, nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), materiale, por me theksim të daisa çështjeve të cilat justifikojnë **dhënien e një opinionit të pakualifikuar**.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës me objekt: “Shërbime supervizimi për punimet civile për rikualifikimet urbane në Vlorë (faza e parë), Himarë dhe Bashkinë Pukë” me vlerë 257,603,515 lekë pa tvsh, rezultoi se është lidhur shtesa nr.1, me vlerë 2,515, 200 lekë me tvsh, për mbikëqyrjen e objektit “Unaza e Vlorës, Faza e II-të”. Në dosje nuk administrohet asnjë dokument për përcaktimin e grupit për hartimin e termave të referencës dhe urdhër prokurimi për realizimin e procedurës së prokurimit, në kundërshtim me pikën 3.7.5. “Procedurat me negociim pa shpallje”, të Udhëzuesit të Prokurimit të CEB, Shtator 2011. Duke iu referuar pikës së mësipërme, mbikëqyrja e objektit “Unaza e Vlorës, Faza e II-të”, nuk është e lidhur teknikisht dhe ekonomikisht me asnjë nga objektet e tjerë, të cilët janë parashikuar të mbikëqyren sipas kontratës bazë. Kontrata bazë e mbikëqyrjes është realizuar pas një procedure prokurimi me faza, ku ofertuesi fitues ka dhënë një ofertë rreth 39% më të ulët se fondi limit, ndërsa për amendamentin nuk është kryer asnjë procedurë negociimi të vlerës së fondit limit (*Trajtuar në faqet nr.33 -43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Për këtë rekomandojmë: Nga FSHZH të merren masa për eliminimin e të gjitha rasteve të shtesave të kontratave për shërbime mbikëqyrje dhe projektimi, për kontrata të reja ndërtimore, sepse në ndryshim nga kontratat e punëve, këto shërbimi nuk janë të lidhura teknikisht dhe ekonomikisht me kontrata të tjera, pavarësisht vendndodhjes së tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i propozimit teknik të JV “T.” sh.p.k & “E.G” sh.p.k, në procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbime supervizimi për punimet civile për rikualifikimet urbane në Vlorë (faza e parë), Himarë (faza e parë) dhe Bashkinë Pukë”, u konstatua se ofertuesi nuk i disponon dy inxhinier materiale, që të jenë diplomuar për inxhinieri ndërtimi (përcaktuar sipas pikës 6.1.1 Key experts të RFP). Ofertuesi ka paraqitur si inxhinier materiale z. L. K., i cili është diplomuar si inxhinier gjeolog dhe z. G.M., i cili është diplomuar si inxhinier mekanik. Asnjë prej të dy ekspertëve të paraqitur nuk është diplomuar për inxhinieri ndërtimi, sic është kërkuar në RFP dhe nuk i përmbush kushtet për inxhinier materiale sic është kërkuar në RFP (*Trajtuar në faqet nr. 33 -43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Për këtë rekomandojmë: Nga FSHZH të merren masat për të ndryshuar kriterin e përcaktimit të diplomës që duhet të ketë inxhinieri i materialeve. Në dokumentet standarde të tenderit në kriteret për kualifikim të përcaktohet që operatorët ekonomikë të kenë në përbërje të stafit të tyre inxhinier materiale të cilët të kenë përfunduar degën fakultetit me të njëjtin emër.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Sipas marrëveshjes midis CEB dhe Ministrisë së Financave të ratifikuar me ligjin nr. 69/2015, pika 6.5 citohet se: “Pragjet mbi të cilat do t’i kërkohej Republikës së

Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, për të marrë furnizimet, punimet dhe shërbimet përmes procedurave ndërkombëtare të prokurimit, janë ato të aplikueshmet nën direktivat e prokurimit përkatës të BE-së, të përditësuara herë pas here dhe të botuara në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (OJEU)”, ndërsa Udhëzuesi i Prokurimeve të CEB sugjeron në pikën 3.8 faqja 13, se, “Për kontrata ku vlera e tyre është nën kufirin e përcaktuar në marrëveshje, procedurat kombëtare mund të jenë mënyra më e përshtatshme e prokurimit për furnizim, punë dhe shërbime”. Sipas PRAG- 5.5 (Local open tender- Tender i hapur lokal) kufiri për kontrata lokale-kombëtare është kur kontratat kanë një vlerë nga 300 000 EURO deri në 5, 000,000 EURO. Kjo pikë e Udhëzuesit të Prokurimeve të CEB nuk është marrë në konsideratë nga FSHZH për zhvillimin e procedurave të prokurimit (Trajtuar në faqet nr. 32 -43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Për këtë rekomandojmë: Nga FSHZH të merren masat për respektimin e plotë të Udhëzuesit të Prokurimeve të CEB, në lidhje aplikimin e procedurave kombëtarë të prokurimit, ku për kontrata të cilat kanë një vlerë poshtë kufirit të ulët monetar (300 000 EUR deri në 5,000,000 EURO), të përdoret ligji shqiptar i prokurimit dhe VKM përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi i propozimit teknik të JV “T.C” sh.p.k & “E. G” sh.p.k, për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbime supervizimi për punimet civile në zonën bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, u konstatua se ofertuesi nuk i disponon një inxhinier mjedisi, i cili të jetë diplomuar në fushat e mjedisit, por ka paraqitur CV e z.A.V., i cili është diplomuar për Biologji. Në dokumentet e ofertuesit nuk administrohet diplomë e z.A.V.. Edhe ofertuesi “D&C P.s” sh.p.k, si inxhinier mjedisi, ka paraqitur z.A.V., i cili është diplomuar për biologji dhe është i njëjti ekspert i paraqitur nga ofertuesi i shpallur fitues JV “T.C” sh.p.k & “E. G” sh.p.k. KVO duhet të kishte s`kualifikuar të dy ofertuesit JV “T.C” sh.p.k & “E. G” sh.p.k dhe “D&C P.” sh.p.k, në bazë të Udhëzuesit të Prokurimit të CEB -Shtator 2011, i cili është subjekti i dispozitave të Direktivës të Prokurimeve 2014/24/EU.

- Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikualifikim urban i zonës bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, JV “Gj.” sh.p.k & “R.” sh.p.k & “A.” sh.p.k, në lidhje me kriterin për disponimit të mjeteve, shoqëritë “Gj.” sh.p.k dhe “R” kanë paraqitur sipas “Appendix B- Equipment”, deklaratë që disponojnë eskavator me zinxhir (backhoe excavator) por nuk kane paraqitur dokumentacion. Gjithashtu dhe për autobotin e ujit kompania “Gj.” sh.p.k nuk ka paraqitur dokument që vërteton zotërimin e autobotit të ujit (Water bowser), megjithëse e ka deklaruar sipas “Appendix B- Equipment” (Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit të Auditimit).

4.1. Për këtë rekomandojmë: Nga FSHZH të merren masat për s`kualifikimin e të gjithë ofertuesve të cilët paraqesin të njëjtin ekspert në ofertat e tyre teknike dhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur për çdo ekspert të kërkuar në dokumentet e tenderit, rast pas rasti.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikim urban, restaurim në fshatin e Dhërmiut, Bashkia Himarë”, ofertuesi i shpallur fitues, JV “R” sh.p.k & “G” sh.p.k, rezultoi se operatorit ekonomik “R” sh.p.k, ka paraqitur si inxhinier ndërtimi një person i cili nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, lindi dyshime se diploma ka mangësi në format. Grupi i auditimit nuk jep nuk mund të

shpërehet për vërtetësinë e saj Në këto kushte KVO duhej ta s`kualifikonte (*Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit të Auditimit*).

5.1. Për këtë rekomandojmë: Nga FSHZH të merren masat për s`kualifikimin e të gjithë ofertuesve të cilët paraqesin dokumente jo autentik dhe penalizimin e këtyre ofertuesëve në procedurat e ardhshme të prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i procedurave të prokurimit për punë ndërtimi, konstatohet se kriteret për kualifikimin e ofertuesëve pjesëmarrës në tender për: kapacitetet financiare (financial capabilities), xhiro mesatare vjetore për punë ndërtimi (average annual construction turnover), eksperiencë specifike në ndërtim për 3 kontrata në 5 vitet e fundit (specific construction experience), janë tepër të forta dhe ngushtojnë konkurrencën, duke sjell kualifikimin e vetëm një numri të vogël operatorësh ekonomik, të cilët konkurojnë me rotacion, në procedura të ndryshme prokurimi duke bërë marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre, për të plotësuar këto kriteret. Këto kriteret janë të përcaktuar në udhëzues prokurimesh për banka të ndryshme, por grupi auditimit nuk ka konstatuar ndonjë dokument ku banka CEB sugjeron përdorimin e këtyre dokumenteve (*Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Për këtë rekomandojmë: Nga FSHZH të merren masat që kriteret për pjesëmarrje në tender të ofertuesëve, të jenë më përfshirëse dhe të mundësojnë pjesëmarrjen në tender jo vetëm të një numri të vogël operatorësh ekonomik, duke iu përmbajtur edhe parimeve të Udhëzuesit të Prokurimeve të CEB, ku specifikohet që procedurat e prokurimit duhet të sigurojnë që të ketë konkurrencë, ekonomikitet, efikasitet dhe transparencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7- Gjetje nga auditimi: Struktura e përgjithshme e termave të referencës për procedurat e prokurimit me objekt “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Vlorës”, “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Himarës”, “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në fshatrat e Dhërmiut dhe Vunoit, Bashkia Himarë” dhe “Shërbime projektimi për rigjenerimin urban të zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, nuk ka reflektuar parimet e menaxhimit të ciklit të projektit dhe nuk ka trajtuar të gjitha çështjet për arritjen e objektivave dhe qëndrueshmërisë së projektit, pasi në dokumentat e prokurimit, kërkesat në lidhje me stafin profesional dhe kualifikimet e tyre janë shumë të ulta duke lejuar pjesëmarrje të ekspertëve të palicencuar dhe pa nivel master, si dhe në listën e ekspertëve nuk kërkohet inxhinier gjeodet, ndonëse ky shërbim është kyc në realizimin e shërbimit të konsulencës dhe është i detyrueshëm për paisjen me leje zhvillimi. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB -Shtator 2011, pika 3.10.5.

Si edhe në kundërshtim me ligjin nr. 107 date 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit” (*Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH për të gjitha procedurat e prokurimit për shërbime konsulence, të financuara nga CEB (Council of Europe Development Bank / Banka për Zhvillim e Këshillit Evropian), të sigurohet që dokumentat e tenderit të përmbajnë të gjitha dispozitat dhe informacionin që kandidatët e ftuar duhet të paraqesin në ofertat e tyre dhe në termat e referencës të reflektohen parimet e menaxhimit të ciklit të projektit dhe të trajtojnë **që të gjitha çështjet** në mënyrë sistematike duke garantuar arritjen e objektivave dhe qëndrueshmërisë së projektit.

Në vijimësi

8 -Gjetje nga auditimi: Në llogaritjen e vlerës së kontratave me objekt “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Vlorës”, “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Himarës”, “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në fshatrat e Dhërmiut dhe Vunoit, Bashkia Himarë” dhe “Shërbime projektimi për rigjenerimin urban të zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, nuk janë përfshirë shërbimet e rilevimit topografik si edhe shërbimi i studimit të ndikimit në mjedis. Mos përfshirja e këtyre dy shërbimeve në llogaritjet e vlerës së kontratës, ka rezultuar në përcaktimin e një vlere kontrate jo në përputhje me VKM nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” të ndryshuar (Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH të përfshijë në llogaritje të gjitha shërbimet e kërkuara për të gjitha procedurat e prokurimit për shërbime konsulence, llogaritja e vlerës së kontratës së të cilave bazohet në 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” të ndryshuar,.

Në vijimësi.

9- Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Vlorës”, “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Himarës”, “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në fshatrat e Dhërmiut dhe Vunoit, Bashkia Himarë” dhe “Shërbime projektimi për rigjenerimin urban të zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, konsulentët nuk kanë paraqitur dokumente që sigurojnë disponueshmërinë e stafit, në kundërshtim me pikën 6.4 të Udhëzuesit për Konsulentët. Mungesa e dokumenteve të disponueshmërisë së stafit shkakton mungesë garancie, përsa i përket realizimit të shërbimit të kërkuar nga stafi i ekspertëve, të cilët përbëjnë faktor kyc në vlerësimin e ofertave (Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH për të gjitha procedurat e prokurimit për shërbime konsulence, të financuara nga CEB (Council of Europe Development Bank / Banka për Zhvillim e Këshillit Evropian), në vlerësimin e stafit kryesor të propozuar, të bazohet në dokumentat e disponueshmërisë së stafit.

Në vijimësi

10- Gjetje nga auditimi: Në shërbimet e konsulencës “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Vlorës”, “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Himarës”, dhe “Shërbime projektimi për rigjenerimin urban të zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, konsulentët nuk kanë hartuar analizat e cmimeve për zërat e punimeve që nuk janë në manual. Për cmimet e zërave të përdorur në preventivat e punimeve, të cilët nuk janë në manual, nuk ka asnjë informacion mbi faktin se ku është bazuar konsulenti për përcaktimin e tyre. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” të ndryshuar (Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH të marrë masa me qëllim shmangien e praktikave të marrjes në dorëzim të preventivave me zëra punimesh që nuk janë në manual dhe për të cilat nuk janë hartuar analizat e cmimeve.

Në vijimësi

11- Gjetje nga auditimi: Konsulenti fitues i procedurës së prokurimit “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Vlorës” ka hartuar projektin P2, “Bulevardi Qendror” në

kundërshtim me kontratën dhe Termat e Referencës, pasi ka parashikuar punime të përkohëshme dhe afatshkurta. Referuar preventivit vlera e punimeve të këtij projekti është 169,476,645 lekë me tvsh dhe planifikimi i këtyre fondeve për punime të cilat pas 2 vitesh do prishen për t'u ndërtuar dikë tjetër, përbën përdorim pa efektivitet të fondeve publike.

Gjithashtu në kundërshtim me sa specifikohet në termat e referencës, ku kërkohet që projekti të parashikojë zëvendësimin e pamlava të sëmurave me pemë të tjera, varianti final i projektit **P2-B1_a** "Hapsira publike dhe mobilim në segmentin jugor" parashikon mbajtjen e trungjeve të palmave të thara dhe instalimin e hijezuesve metalik në to. Ndonëse në kontratë kërkohet që konsulenti të trajtojë të gjithë segmentin jugor të bulevardit nga sheshi "Avni Rustemi" deri në Skelë, faktikisht ai ka trajtuar vetëm një pjesë prej 488.6 ml (*Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH për të gjitha procedurat e prokurimit për shërbime konsulence, të financuara nga CEB (Council of Europe Development Bank / Banka për Zhvillim e Këshillit Evropian), të mos marrë në dorëzim dhe të paguajë projekte që janë hartuar në kundërshtim me Termat e Referencës dhe kushtet e kontratës si edhe që parashikojnë përdorim pa efektivitet të fondeve publike.

Në vijimësi

12- Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit "Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Himarës" konsulentit fitues S. E. & C. shpk, ka propozuar një ekspert që nuk i plotëson kërkesat minimale për kriterin e vlerësimit "ekspert urbanist". Në këtë rast e gjithë ofera duhej të refuzohej. Eksperti Urbanist i propozuar zj. A. K.. nuk ka një diplomë në Urbanistikë. Ky fakt nuk është konsideruar nga KVO në raportin e vlerësimit teknik, pasi ky ekspert është vlerësuar me 9 nga 10 pikë të mundshme, ndonëse nuk përmbush kërkesat e Termave të Referencës. Vlerësimi i bërë nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave është në kundërshtim me kërkesat e tenderit, duke favorizuar një operator i cili nuk përmbush kriteret minimale të stafit të propozuar. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB -Shtator 2011, pika 2.21 (*Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH, për të gjitha procedurat e prokurimit për shërbime konsulence, të financuara nga CEB (Council of Europe Development Bank / Banka për Zhvillim e Këshillit Evropian), në vlerësimin e ofertave të vlerësojnë çdo propozim në bazë të përputhshmërisë të tij ndaj Termave të referencës dhe të refuzjë ofertat që i përmbush kushtet e rëndësishme të përshkruara në Kërkesat për Propozim.

Në vijimësi

13- Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit "Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Himarës" dhe "Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në fshatrat e Dhërmiut dhe Vunoit, Bashkia Himarë" konsulenti fitues S. E. & C., në dokumentat e paraqitura, ka bërë deklarime të rreme.

Gjithashtu administratori i kësaj kompanie z. E. B, me detyrën e arkitektit dhe planifikuesit urban në këtë kontratë, në CV-në e tij deklaroi se ka punuar në shoqërinë "S. E. & C." shpk që nga viti 2011 e në vazhdim.

zj. A. K., inxhinere, paraqet në CV-në e saj eksperiencë me shoqërinë "S.E. & C." shpk që nga viti 1995. z. A. P., inxhinier ndërtimit, paraqet në CV-në e tij eksperiencë me shoqërinë "S.E. & C." shpk që prej vitit 2006. Zj. K. D., arkitekte, paraqet në CV-në e tij eksperiencë me shoqërinë "S.E. & C." shpk që prej vitit 2005.

Deklarimet e bëra në profilin e shoqërisë "S. E. & C." shpk përsa i përket përvojave si edhe deklaratimet në CV-të e ekspertëve janë të rreme pasi kjo shoqëri është themeluar në 19.02.2015,

regjistruar në 24.02.2015 dhe licencuar në projektim në qershor po të 2015-tës. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB 2011, pika 3.9.12 *Vlerësimi i ofertuesve dhe dhënia e kontratës*.

Paraqitja e deklarimeve të rreme në këtë procedurë ka rezultuar në vlerësim të gabuar të ofertës (*Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH, të marrë masa për përjashtimin e subjektit “S. E. & C.” shpk nga procedurat dhe kontratat e financuara nga CEB.

Menjëherë

14- Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Himarës” Konsulenti fitues S. E. & C. shpk, nuk ka përmbushur kondicionet e kontratës.

Konsulenti nuk ka zbatuar detyrimin e hartimit të preventivave, specifikimeve teknike, relacioneve dhe VNM për projektet e Kepit të Spiles dhe Projektin arkitektonik të rikualifikimit të godinës së Bashkisë Himarë, ndërkohë që konsulenti nuk ka realizuar Projektin e rikonstruksionit të ndërtesave të vjetra të Bashkisë Himarë. Konsulenti gjithashtu nuk ka zbatuar detyrimin kontraktor të përgatitjes së pamjeve tre dimensionale dhe animeacioneve për projektin e rivitalizimit të fasadave në objektet ekzistuese.

Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 02.3.2 të shërbimeve të kërkuara në kontratën e nënshkruar më datë 21.03.2016 ndërmjet autoritetit kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, përfaqësuar nga z. B. B. dhe Konsulentit S. E. & C. shpk, përfaqësuar nga z. E. B. (*Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH të marrë masa me qëllim shmangien e praktikave për marrjen në dorëzim të shërbimeve të konsulencës që nuk plotësojnë detyrimet kontraktore dhe termat e referencës.

Në vijimësi

15- Gjetje nga auditimi: KVO për procedurën e prokurimit “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në fshatrat e Dhërmiut dhe Vunoit, Bashkia Himarë” ka vlerësuar dëshmi të pa shoqëruara nga dokumentacion vërtetues dhe ka vlerësuar dokumentacion të papërkthyer në anglisht. Operatori fitues BOE “A.” slp dhe “S. E. & C.” shpk, të gjithë dokumentat financiare e fazës së parë, për përzgjedhjen për vazhdimin e konkurimit, i ka paraqitur në gjuhën spanjolle të papërkthyer në anglisht. Po në kundërshtim me atë se çfarë është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor grupi i operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur në detajet e përvojës për detyra të ngjashme, vlerën e kontratave të mëparshme si edhe certifikatat e lëshuara nga klienti për përfundimin e mirë të detyrës. Kjo në kundërshtim me pikën 3.9.12 të Udhëzuesit të Prokurimit të CEB 2011 ku specifikohet se:

Për pasojë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka patur kompetencën që të japë një vlerësim në lidhje me përmbushjen e këtyre kriterëve (*Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1- Për këtë rekomandojmë: Për të gjitha procedurat e prokurimit për shërbime konsulence, të financuara nga CEB (Council of Europe Development Bank / Banka për Zhvillim e Këshillit Evropian), FSHZH në vlerësimin e kualifikimeve teknike dhe financiare të ofertuesit, të sigurohet për aftësitë e tyre në lidhje me kontratën specifike, dhe të sigurohet se ofertat plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë të specifikuara në dokumentet e tenderit.

Në vijimësi

16- Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në fshatrat e Dhërmiut dhe Vunoit, Bashkia Himarë” bashkimi i operatorëve ekonomik “A.”slp dhe “S. E. & C.” shpk, ka paraqitur dy deklarata të ndryshme të përbërjes së stafit të ekspertëve duke propozuar ekspertë të ndryshëm për të njëjtin pozicion.

Numri i ekspertëve të propozuar është 12 nga 8 ekspertë që kërkohen në Termat e Referencës dhe për të cilët bëhet vlerësimi. Nuk është bërë dallimi mes ekspertëve kyc nga ata jo kyc. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB 2011, pika 3.9.12 *Vlerësimi i ofertuesve dhe dhënia e kontratës* dhe në kundërshtim me pikën 5.2 a) të Udhëzuesit për Konsulentët.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar stafin e ekspertëve të operatorit fitues në kushtet kur ky i fundit nuk ka qenë në thelb i përgjegjshëm dhe dokumentacioni i paraqitur prej tij përmban devijime materiale ose rezerva ndaj termave, kushteve dhe specifikimeve në dokumentet e tenderit (*Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1- Për këtë rekomandojmë: Për të gjitha procedurat e prokurimit për shërbime konsulence, të financuara nga CEB (Council of Europe Development Bank / Banka për Zhvillim e Këshillit Evropian), FSHZH të mos marrë në konsideratë në vlerësim ofertues që nuk janë në thelb të përgjegjshëm, ofertat e të cilëve përmbajnë devijime materiale ose rezerva ndaj termave, kushteve dhe specifikimeve në dokumentet e tenderit.

Në vijimësi

17- Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikualifikim Urban në Bashkinë e Vlorës, Faza e Parë”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike dhe observacioneve, rezultojnë se punimet me vlerë 825,140 lekë pa tvsh nuk ishin kryer në momentin e verifikimit në terren, por sipas fotove të observacioneve të aktkonstatimit, janë kryer. FSHZH ka më tepër paguar vlerën 825,140 lekë pa TVSh, megjithëse punimet janë kryer me vonësë dhe mbas verifikimit në terren të audituesëve të KLSH (*Trajtuar në faqet nr. 88 - 114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Për këtë rekomandojmë: Nga FSHZH, nëpërmjet strukturës së Auditit të Brendshëm, të marrin të gjitha masat për verifikimin e të gjitha punimeve që pretendohen të realizuara në komentet e paraqitura nga mbikëqyrësi i punimeve. Gjithashtu FSHZH në vazhdimësi të ushtrojë kontroll të rreptë dhe në mënyrë të detajuar të kontratave, jo vetëm në aspektin financiar dhe juridik, por edhe në aspektin inxhinierik të kryerjes së punimeve faktike në terren, përpara se të kryehet pagesa e situacionit përfundimtar, edhe pse është sigluar nga menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

18- Gjetje nga auditimi: Nga FSHZH, për 11 projekte me vlerë mbi 100 milion lekë, në vlerë totale 3,084,270,833 lekë, nuk është kryer oponenca teknike, veprim në kundërshtim me ligjin nr.8402, date 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” ndryshuar, neni 6, me efekt pasaktësitë e hasura në projekte dhe preventiva (*Trajtuar në faqet nr. 88 - 114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH, në projekte me vlerë mbi 100,000,000 lekë të kryejë oponencën teknike.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtimi i Unazës së Vlorës LOTI 2 dhe Rehabilitimi i zonave publike përballë rrugës së shëtitores”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **3,837,301 pa tvsh**. Veprimet e

mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr.CWPIV/W/OP/2016/5 Datë 17.05.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor, FSHZH dhe “G. 2” sh.p.k (*Trajtuar në faqet nr. 88 - 114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1. Për këtë rekomandojmë: Nga FSHZH dhe mbikqyrësi i punimeve të merren masa dhe të kërkohet nga OE “G.2” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën Nr.CWPIV/W/OP/2016/5, datë 17.05.2017 me objekt “*Ndërtimi i Unazës së Vlorës LOTI 2 dhe Rehabilitimi i zonave publike përballë rrugës së shëtitorës*”, kryerja e punimeve të situacionuara por të pakryera në vlerën **3,837,301 pa tvsh**, duke qenë se kontrata e sipërmarrjes është brenda afatit të realizimit dhe punimet janë në proces zbatimi. Gjithashtu volumet e këtyre punimeve të rakordohen në situacionin përfundimtar, në rast të kundërt kjo vlerë të zbritet nga vlera përfundimtare e situacionit.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Në investimin me objekt “*Restaurimi dhe rehabilitimi i fasadave të banesave kolektive në zonën e mbrojtur dhe në vazhdim për unifikimin me objektet e bulevardit 18 Shtatori në qytetin e Gjirokastrës*” për të cilin është lidhur kontrata e sipërmarrjes me OE “R.” sh.p.k me nr. CWPIV/W/CS/RP/2016/8 datë 28.02.2017, me vlerë të kontratës 242,676,397 lekë me tvsh, nga inspektimi i 12 objekteve nga 129 në total, me përjashtim të objekteve nr. 29 dhe 51, u konstatua ishin me mangësi, me diferenca në volume pune në vlerën 8,142,824 pa tvsh, në kundërshtim me nenin 4 dhe 7 të ligjit nr. 8402, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, UKM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë, UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 9 dhe UKM nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4 (*Trajtuar në faqet nr. 88 -114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1. Për këtë rekomandojmë: Nga FSHZH, të merren masa, nëpërmjet një grupi specialistësh përkatës sipas nevojave të investimit, për verifikimin e objekteve të pa inspektuara në terren nga përfaqësuesit e KLSH – së. Ky inspektim, me qëllim identifikimin e punimeve për volumet e punës të likuiduara, në 117 banesat e pa inspektuara nga 129 në total, të dokumentohet me procesverbalet përkatëse për çdo godinë.

20.2. Për këtë rekomandojmë: Nga FSHZH dhe mbikqyrësi i punimeve të merren masa dhe të kërkohet nga OE “R.” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. CWPIV/W/CS/RP/2016/8 datë 28.02.2017 me objekt “*Restaurimi dhe rehabilitimi i fasadave të banesave kolektive në zonën e mbrojtur dhe në vazhdim për unifikimin me objektet e bulevardit 18 Shtatori në qytetin e Gjirokastrës*”, që për punimet e situacionuara por të pakryera në vlerën 8,142,824 pa tvsh, duke qenë se kontrata e sipërmarrjes është brenda afatit të realizimit dhe punimet janë në proces zbatimi, volumet e punimeve të pakryera të rakordohen në situacionin përfundimtar.

Menjëherë

B 1- MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikualifikim Urban në Bashkinë e Vlorës, Faza e Parë*”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera

në fakt në vlerën **1,423,275.4 pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr.CWPIV/W/OP/2016/1, datë 09.09.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor, FSHZH dhe JV “E.s” sh.p.k & “A.” sh.p.k. (Trajtuar në faqet nr.88-114 të Raportit të Auditimit).

1.1. Për këtë rekomandojmë: Nga FSHZH të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,423,275.4 pa tvsh** nga JV “E.” sh.p.k & “A.” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën Nr.CWPIV/W/OP/2016/1, datë 09.09.2016 me objekt “Rikualifikim Urban në Bashkinë e Vlorës, Faza e Parë”, vlerë kjo e cila perben dëm ekonomik, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

2-Gjetje nga auditimi: Për projektet P2-B1_a “Hapsira publike dhe mobilim në segmentin jugor” dhe P2-C6 “Shesh public dhe kopësht Petro Marko” të realizuara si pjesë e projektit “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Vlorës”, konsulentit “S.” shpk i është paguar 4,007,883 lekë me tvsh, më shumë se vlera e shërbimit të kryer prej tij. Vlera e kontratës së shërbimit llogaritet bazuar në VKM nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” të ndryshuar, si përqindje e vlerës së punimeve të llogaritura. Nga vlera totale e punimeve konsulenti nuk e ka kryer shërbimin e projektimit për vlerën e punimeve prej 98,914,403 lekë pa tvsh. Sa më sipër konsulenti është paguar 10,679,684 lekë me tvsh, ndërkohë që vlera e shërbimit të kryer prej tij është 6,671,801 lekë me tvsh. Diferenca prej 4,007,883 lekë me tvsh, që i është paguar konsulentit për një shërbim që ai nuk e ka kryer dhe përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit (Trajtuar në faqet nr.88- 114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH të marrë masa për arkëtimin e dëmit ekonomik prej 4,007,883 lekë me tvsh shkaktuar prej konsulentit “S.” shpk.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: FSHZH ka prokuruar dhe realizuar dy herë të njëjtin shërbim konsulence për projektin e Bulevardit Qendror Vlorë, një herë si pjesë e procedurës “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Vlorës” financuar nga CEB (Council of Europe Development Bank / Banka për Zhvillim e Këshillit Evropian), në kuadër të projektit LD 1853 (2014) “Punët e Komunitetit IV” dhe një herë tjetër ka kryer të njëjtin prokurim në kuadër të një projekti tjetër, i cili nuk është objekt i këtij auditimi. Prokurimi i punimeve për Bulevardin Qendror të Vlorës është bërë bazuar në projektin e dytë të hartuar. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 2.

Duke qenë se për prokurimin e punimeve, FSHZH ka përdorur projektin e dytë të Bulevardit Qendror Vlorë, vlera e shërbimit të konsulencës së paguar për projektin e parë, P2-B1_a “Hapsira publike dhe mobilim në segmentin jugor” bazuar në VKM nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” të ndryshuar, llogaritur për vlerën e preventivuar të punimeve sipas Grupit tarifor III, struktura në ambjentet e jashtme, duke përdorur përqindjen e shumës së projekteve P2, është 7,817,838 lekë me tvsh dhe përbën dëm ekonomik shkaktuar nga FSHZH si rezultat i shpërdorimit të fondeve publike (Trajtuar në faqet nr.88 -114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH të marrë masa për te ndjekur te gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **7,817,838 lekë me tvsh** nga personat përgjegjës: z. A. B. Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve dhe z. E O Drejtor i NJZP.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Kontratës me objekt “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Himarës”, nuk i është bërë shtojcë mbi bazën e rillogaritjes së tarifës së shërbimit, mbas përfundimit të fazës së shtatë të shërbimit: “Organizimi i procedurës dhe vlerësimi i tenderit”, ku vendoset “Kostoja e llogaritshme e tenderuar” sipas nenit 7, pika 8. Nga rillogaritja e kostos së kontratës rezulton se vlera që i është paguar konsulentit “S E & C” shpk është 2,051,677 lekë me tvsh më shumë se vlera e rillogaritur e shërbimit. Mungesa e rillogaritjes së tarifës së shërbimit ka shkaktuar realizimin e pagesave të shërbimit të konsulencës, jo në përputhje me në VKM nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” të ndryshuar. Për këtë është shkaktuar dëm ekonomik në vlerë 2,051,677 lekë me tvsh, i përfituar padrejtësisht nga konsulenti për një shërbim të pakryer (*Trajtuar në faqet nr.88 -114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Për këtë rekomandojmë: FSHZH të kërkojë arkëtimin e dëmit ekonomik prej **2,051,677 lekë me tvsh**, përfituar padrejtësisht nga konsulenti “S E & C” shpk për një shërbim të pakryer.

Menjëherë

B 1.1 DËM EKONOMIK PONTENCIAL

1 - Gjetje nga auditimi: Për projektin P2-C6 “Shesh publik dhe kopësht Petro Marko” “S A” shpk ka preventivuar zëra e volume pune në kundërshtim me përcaktimet e projektit të zbatimit në vlerën 2,807,348 lekë me tvsh, zërat e punimeve të paraqitur në tabelën nr. 3. Konsulenti ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 3 dhe 5 (*Trajtuar në faqet nr.28 -88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH të marri masa që shuma prej **2,807,348 lekë me tvsh** të vlerës së preventivit e preventivuar me tepër të zbritet gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në rast të kundërt të klasifikohet dëm ekonomik dhe të merren masa për arkëtimin e vlerës nga përfituesi.

Në vijimësi

2 -Gjetje nga auditimi: Projektet e realizuara nga “S E & C” shpk ,për “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në fshatrat e Dhërmiut dhe Vunoit, Bashkia Himarë”, kanë preventiva të shtuar në mënyrë artificiale, pasi paraqesin zëra e volume punimesh për të cilat nuk është hartuar projekt. Nga auditimi i dosjes së shërbimit të projektimit të kryer dhe matjet dixhitale të kryera në projektin e zbatimit të punimeve si dhe rakordimit të tyre me preventivin e punimeve rezulton se për zërin e punimeve *An. Shtresë pllaka guri 10*10cm të skuadruara*, është preventivuar një sasi prej 6,673 m² më shumë se sa rezulton nga matjet në projekt, përkatësisht 2,598 m² në proejktin e Vunoit dhe 4,075m² në projektin e Dhërmiut, të barazvlefshme me shumën prej 13,093,920 lekë me tvsh për projektin në Vuno dhe 20,538,000 lekë me tvsh në projektin e Dhërmiut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 3 dhe 5. Për sa më sipër hartimi i preventivit nuk është bërë në përputhje me projektin e zbatimit, e konkretisht janë preventivuar volume pune më tepër se projekti i zbatimit duke rezultuar në shtesë artificiale të vlerës së preventivit që ka sjellë llogaritje të gabuar të fondit limit të punimeve në vlerën 13,093,920 lekë me tvsh për projektin në Vuno dhe 20,538,000 lekë me tvsh

në projektin e Dhërmiut duke shkaktuar efekt negativ në menaxhimin e fondeve publike (Trajtuar në faqet nr. 28- 88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH të marrë masa që shuma prej **13,093,920 lekë me tvsh** të fondit limit për projektin në Vuno dhe 20,538,000 lekë me tvsh të fondit limit për projektin e Dhërmiut, të zbritet gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në rast të kundërt të klasifikohet dem ekonomik dhe merren masa për arkëtimin e vlerës nga përfituesi.

Në vijimësi

3 -Gjetje nga auditimi: Projektet e realizuara nga “S A” shpk për “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Vlorës”, kanë preventiva të shtuar në mënyrë artificiale, pasi paraqesin zëra e volume punimesh për të cilat nuk është hartuar projekt.

Për projektin P1-C7_b “Terminali i autobuzëve – Shesh publik + Facilitete” (te godina e vjetër e stacionit të trenit), janë preventivuar zëra e volume pune në kundërshtim me përcaktimet e projektit të zbatimit në vlerën 5,853,225 lekë me tvsh. Kjo si rrjedhojë e preventivimit të volumeve më tepër se parashikon proejkti, të paraqitura në tabelën nr. 2, si edhe nga llogaritja e zërit të punimit 2.37/5a, transport dheu me auto deri 5 km, e cila është bërë me cmim ndryshe nga manuali, përkatësisht me 148 lekë/m³ më shumë se cmimi në manual, dhe për sasinë 4508.5 m³, ka sjellë shtesë në preventivin e punimeve prej 800,709 lekë me tvsh.

Për sa më sipër konsulenti ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 3 dhe 5, VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” ndryshuar, neni 2.

Për projektin P1-C7_b, vlera e preventivit e pregatitur shërben si fond limit për procedurën e prokurimit të punimeve, rritja artificiale e vlerës së këtij preventivi sjellë llogaritje të gabuar të fondit limit me shumën prej 5,853,225 lekë me tvsh duke shkaktuar efekt negativ në përdorim te fondeve publike (Trajtuar në faqet nr.28 -88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1- Për këtë rekomandojmë: Për rritjen artificiale prej **5,853,225 lekë** me tvsh të vlerës së preventivit në projektin P1-C7_b “Terminali i autobuzëve – Shesh publik + Facilitete” (te godina e vjetër e stacionit të trenit) dhe projektin P1-C7_c “Shesh publik dhe parkim” (përballë sheshit të terminalit të autobuzëve), FSHZH të marrë masa që para shpalljes se procedurës se prokurimit për realizimin e punimeve të zbresë këtë shumë nga fondi limit, shume e cila përbën dem ekonomik potencial dhe ne te kundërtën të merren masa për arkëtimin e vlerës nga përfituesi.

Menjëherë ne vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi:

- Në projektin “Shërbime projektimi për rigjenerimin urban të zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë” janë preventivuar zëra punimesh me çmim më të lartë se sa parashikon manuali. Nga auditimi në preventivin e punimeve konstatohet se për zërin *Shtrese çakelli mbeturine kave t=30cm, perhapur e ngjeshur makineri*, preventivuesi ka përcaktuar cmimin duke mbledhur shumat e zërave 3.209 *Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, perhapur e ngjeshur makineri* dhe 3.211 *Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri*. Në këtë rast referuar analizës së cmimeve, cmimi i këtij zëri punimesh duhet të ishte 1031 lekë/m² nga 1,646 lekë/m² të preventivuara.

Sa më sipër është në kundërshtim me VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”

Diferenca e cmimit prej 615 lekë/m² për një sipërfaqe shtresë cakëlli të preventivuar prej 31,475 m² rezulton në vlerën 23,228,550 lekë me tvsh, vlerë e cila përbën preventivim të gabuar të volumeve të punës duke rezultuar në shtesa artificiale të tij.

Kontrata e sipërmarrjes është firmosur datë 05.07.2017, me vlerë 577,848,134 lekë me tvsh, midis autoritetit kontraktor FSHZH përfaqësuar nga z. B B dhe bashkimit të operatorëve ekonomik R shpk & G , përfaqësuar nga z. R T . Diferenca e vlerës së fondit limit që duhej të ishte perlllogaritur dhe vleres se kontrates se nënshkruar është në shumën 12,569,385 lekë. Për sa më sipër rezulton se shuma prej 12,569,385 lekë me tvsh përben efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit i shkaktuar si rrjedhojë e preventivimit të gabuar.

- Kontratës me objekt “Shërbime projektimi për rigjenerimin urban të zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, nuk i është bërë shtojcë mbi bazën e rillogaritjes së tarifës së shërbimit, mbas përfundimit të fazës së shtatë të shërbimit: “Organizimi i procedurës dhe vlerësimi i tenderit”, ku vendoset “Kostoja e llogaritshme e tenderuar” sipas nenit 7, pika 8 të VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Nga rillogaritja e tarifës së shërbimit bazuar në koston e llogaritshme të tenderuar duke zbritur vlerën e punimeve të preventivuar gabim, referuar përqindjes maksimale të grupit tarifor, duke përdorur interpolimin rezulton se tarifa e rillogaritur e shërbimit është 16,797,409 lekë me tvsh.

Vlera që i është paguar konsulentit është 20,498,803 lekë me tvsh dhe është 3,701,394 lekë me tvsh më shumë se vlera e rillogaritur e shërbimit, e cila përbën edhe vlerën që duhej të ishte paguar konsulentit. Mungesa e rillogaritjes së tarifës së shërbimit ka shkaktuar realizimin e pagesave të shërbimit të konsulencës, jo në përputhje me vlerën reale të këtij shërbimi. Për këtë është shkaktuar efekt negativ financiar në vlerë **3,701,394 lekë me tvsh** (Trajtuar në faqet nr.88 -114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1- Për këtë rekomandojmë: FSHZH të marrë masa që të kontrollojë analizat e çmimeve të paraqitura nga projektuesit në shumën **3,701,394 lekë me tvsh**, përpara marrjes në dorëzim të projektit si dhe të bëjë përditësim të çmimeve përpara hapjes së procedurave të prokurimit, shume e cila konsiderohet dëm ekonomik potencial dhe në të kundërtën të merren masa për arkëtimin e vlerës nga përfituesi.

Menjëherë

B 2 - MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1 -Gjetje nga auditimi: Projektet e realizuara për “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Himarës”, kanë preventiva të shtuar në mënyrë artificiale, pasi paraqesin zëra e volume punimesh për të cilat nuk është hartuar projekt. Nga matjet dixhitale të kryera në projektin e zbatimit të punimeve dhe rakordimit të tyre me preventivin e punimeve rezulton se për zërat e punimeve paraqitur në tabelën nr. 4, janë preventivuar volume pune më shumë se sa rezulton nga matjet në projekt, të barazvlefshme me shumën prej 15,509,322 lekë me tvsh. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 3 dhe 5.

Vlera e preventivit e pregatitur në këtë shërbim konsulence shërben si fond limit për procedurën e prokurimit të punimeve, ndaj rritja artificiale e vlerës së këtij preventivi ka sjellë llogaritje të gabuar të fondit limit me shumën prej 15,509,322 lekë me tvsh duke shkaktuar efekt negativ në

menaxhimin e fondeve publike (*Trajtuar në faqet nr. 28-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1- Për këtë rekomandojmë: Për rritjen artificiale prej 15,509,322 lekë me tvsh të vlerës së fondit limit për realizimin e punimeve për projektin e rikualifikimit urban në Bashkinë e Himarës, FSHZH të marrë masa që kjo shumë të zbritet nga situacionet e punimeve, sipas sasive dhe zërave të punimeve të paraqitura në tabelën nr. 4.

Në vijimësi

2-Gjetje nga auditimi: Në projektin “Shërbime projektimi për rigjenerimin urban të zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë” hartimi i preventivit nuk është bërë në përputhje me projektin e zbatimit, e konkretisht janë preventivuar volume pune më tepër se projekti i zbatimit. Nga matjet dixhitale të kryera në projektin e zbatimit të punimeve për projektin e Dhërmiut dhe rakordimit të tyre me preventivin e punimeve rezulton se janë preventivuar sasi më të mëdha se ato të parashikuara në projekt për zërat e punimeve të paraqitur në tabelën nr. 5, në vlerën 10,042,949 lekë me tvsh.

Nga matjet dixhitale të kryera në projektin e zbatimit të punimeve për projektin e Jalës dhe rakordimit të tyre me preventivin e punimeve rezulton se është preventivuar një sasi prej 102 m² më shumë për zërin *shtrim me pllaka guri dim (10x10x10)cm (I kuq - Lezhe)*, duke ja hequr këtë sasi *zërit shtrim me pllaka guri dim (10x10x10)cm (bezhe-Kruje)*. Referaur preventivit diferenca në cmim e këtyre dy zërave është 3,200 lekë/m² e cila për një sasi prej 102 m² *shtrim me pllaka guri dim (10x10x10)cm (i kuq - Lezhe)* ka vlerën **391,680 lekë me tvsh** që përbën vlerë të preventivuar më shumë se sa përcakton projekt zbatimi. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 3 dhe 5.

Hartimi i preventivit nuk është bërë në përputhje me projektin e zbatimit, e konkretisht janë preventivuar volume pune më tepër se projekti i zbatimit, kjo ka rezultuar në shtesë artificiale të vlerës së preventivit të punimeve në vlerën 10,434,629 lekë me tvsh që ka sjellë llogaritje të gabuar të fondit limit duke shkaktuar efekt negativ në menaxhimin e fondeve publike (*Trajtuar në faqet nr. 28- 88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1- Për këtë rekomandojmë: Për rritjen artificiale prej 10,434,629 lekë me tvsh të fondit limit për punimet e rigjenerimit urban të zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, FSHZH të marrë masa që kjo shumë me zërat dhe volumet e paraqitura në tabelën nr. 5, të zbriten gjate kryerjes se punimeve.

Në vijimësi

C-MASA ADMINISTRATIVE:

C/1-Masa për heqjen e licencës profesionale të Shoqërive, Mbikëqyrësve apo Kolaudatorëve (Ministria e Energjetikes dhe Infrastrukturës).

Gjetja: Projektet e realizuara për “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Vlorës” nga “S A” shpk, kanë preventiva të shtuar në mënyrë artificiale, pasi paraqesin zëra e volume punimesh për të cilat nuk është hartuar projekt.

- Për projektin P2-B1_a “Hapsira publike dhe mobilim në segmentin jugor” janë preventivuar zëra dhe volume punimesh për të cilat nuk është hartuar projekt, në vlerën 115,889,935 lekë me tvsh.

-Për projektin P1-C7_b “Terminali i autobuzëve – Shesh publik + Facilitete” (te godina e vjetër e stacionit të trenit) dhe projektin P1-C7_c “Shesh publik dhe parkim” (përballë sheshit të terminalit të autobuzëve), janë preventivuar zëra e volume pune në kundërshtim me përcaktimet e projektit të zbatimit në vlerën 5,853,225 lekë me tvsh.

-Për projektin P2-C6 “Shesh publik dhe kopësht Petro Marko” janë preventivuar zëra e volume pune në kundërshtim me përcaktimet e projektit të zbatimit në vlerën 2,807,348 lekë me tvsh.

Për sa më sipër konsulenti ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 3 dhe 5, VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 2. Vlera e preventivit e pregatitur në këto shërbime konsulence ka shërbyer si fond limit për procedurën e prokurimit të punimeve, ndaj rritja artificiale e vlerës së këtyre preventivave ka sjellë llogaritje të gabuar të fondeve limit duke shkaktuar efekt negativ në menaxhimin e fondeve publike.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e punimeve të ndërtimit në nenet 3 dhe 5, të ligjit 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt konstatimin nr. 1, datë 12.04.2018, vërejtjeve komentet të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në kreun VI, neni 41, Pika 3, “Sanksione dhe dispozita kalimtare”, të nenit 41 VKM nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë** Komisionit të Dhënies së Licencave, pranë Ministrisë së Energjetikes dhe Infrastrukturës që të vlerësojë shkeljet e konstatuara duke vendosur sanksionin e heqjes së licencës së ushtrimit të profesionit për subjektin projektues “S.A” shpk.

Menjëherë

Gjetja: Projektet e hartuara për “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në Bashkinë e Himarës” dhe “Shërbime projektimi për rikualifikimin urban në fshatrat e Dhërmiut dhe Vunoit, Bashkia Himarë” nga “S. E. & C.” shpk, kanë preventiva të shtuar në mënyrë artificiale, pasi paraqesin zëra e volume punimesh për të cilat nuk është hartuar projekt., në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 3 dhe 5. Vlera e preventivit e pregatitur në këto shërbime konsulence ka shërbyer si fond limit për procedurën e prokurimit të punimeve, ndaj rritja artificiale e vlerës së këtyre preventivave ka sjellë llogaritje të gabuar të fondeve limit duke shkaktuar efekt negativ në menaxhimin e fondeve publike.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e punimeve të ndërtimit në nenet 3 dhe 5, të ligjit 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt konstatimet nr. 2 dhe 3, datë 12.04.2018, vërejtjeve komentet të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në kreun VI, Neni 41, Pika 3, “Sanksione dhe dispozita kalimtare”, të nenit 4,1 VKM nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, , “Për licencimin professional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të

zbatimit në ndërtim” dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i **rekomandojmë** Komisionit të Dhënies së Licencave, pranë Ministrisë së Energjetikës dhe Infrastrukturës që të vlerësojë shkeljet e kontatuara duke vendosur sanksionin e heqjes së licencës së ushtrimit të profesionit për subjektin projektues “S. E. & C.” shpk.

Menjëherë

C/2 - Masa administrative të rekomanduara për Inspektoratin të Mbrojtjes së Territorit Vendor, (IMTV)

FSHZH ka kryer punime pa leje ndërtimi për objektet: “Rikualifikimi urban në Bashkinë Pukë”; “Rigjenerim urban i hapsirës bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, “Rikualifikim urban dhe restaurim në fshatin Dhërmi Bashkia Himarë”; “Rikualifikim urban dhe restaurim në fshatin Vuno, Bashkia Himarë”, “Riparim dhe ndërtim i infrastrukturës rrugore, belvederes dhe plazhit publik Dhraleo, Bashkia Himarë”, në kundërshtim me nenin 39 të ligjit nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, nenin 13, pika 5 të VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar. Kryerja e punimeve pa leje nga zhvilluesi Fondi Shqiptar i Zhvillimit, përbën kundërvajtje penale konform ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 15/a. Mungesa e lejes së ndërtimit ka ndikuar në saktësinë e projekteve pasi është evituar hallka finale e kontrollit dhe miratimit të tyre.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e punimeve të ndërtimit në nenin 39, të Ligjit nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt konstatimin nr. 5, datë 12.04.2018, vërejtjeve komentet të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 52 pika 1/e, të ligjit nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, i **rekomandojmë** Inspektorateteve të Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkive Himarë, dhe Pukë, që të vlerësojë shkeljet e kontatuara duke marrë masa për punimet e kryera pa leje nga zhvilluesi i punimeve Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Menjëherë

C/3. Masa administrative të rekomanduara Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vlorë.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i **rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Vlorë, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë për mbikëqyrësin** e punimeve:

- **Ë. C.**, në masën **200,000 lekë** për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin:

a. “Rikualifikim Urban në Bashkinë e Vlorës, Faza I”, me sipërmarrës punimesh BOE “E.” sh.p.k & “A.” sh.p.k, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt dhe vendosjes së zërave të punimeve jo sipas specifikimeve teknike të projektit dhe preventivit në vlerën **1,423,275.4 pa tvsh**;

b. “Ndërtimi i Unazës së Vlorës Loti 2” dhe “Rehabilitimi i zonave publike përballë rrugës së shëtitores” me sipërmarrës punimesh kontraktorin “G. 2” sh.p.k, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt dhe vendosjes së zërave të punimeve jo sipas specifikimeve teknike të projektit dhe preventivit në vlerën në vlerën **3,675,634 lekë pa tvsh**.

D. MASA DISIPLINORE

D.1. *Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” si dhe pikës 377, germa a, b, c dhe d, të Manualit të Procedurave të FSHZH-së, i rekomandoj Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH-së, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje me shkrim” deri “Kalim në detyrë apo nivel page më të ulët nga 30 ditë deri në 1 vit” në zbatim të nenit 12 të Kontratës individuale të punës, për personat si më poshtë:*

1- E. O., me detyrë Menaxher i Projektit, pasi:

-në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbime supervizimi për punimet civile për rikualifikimet urbane në Vlorë (faza e parë), Himarë (faza e parë) dhe Bashkinë Pukë”, ka kualifikuar JV “T.” sh.p.k & “E. G” sh.p.k me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB, Shtator 2011, Direktivës së Prokurimeve 2014/24/EU dhe Procedurave dhe Guidave Praktike për Prokurimet (PRAG -15.01.2016) dhe Dokumenteve të tenderit (Request for Proposal) të miratuara nga FSHZH.

-në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbime supervizimi për punimet civile në zonën bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, ka kualifikuar JV “T.” sh.p.k & “E. G” sh.p.k me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB, Shtator 2011, Direktivës së Prokurimeve 2014/24/EU dhe Procedurave dhe Guidave Praktike për Prokurimet (PRAG -15.01.2016)dhe Dokumenteve të tenderit (Request for Proposal) të miratuara nga FSHZH.

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikim urban i zonës bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, ka s`kualifikuar padrejtësisht ofertuesin“GPG” sh.p.k dhe ka kualifikuar me mangësi në dokumentacion JV “Gj.” sh.p.k & “R.” sh.p.k & “A.” sh.p.k, në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB, Shtator 2011, Direktivës së Prokurimeve 2014/24/EU dhe Procedurave dhe Guidave Praktike për Prokurimet (PRAG -15.01.2016)dhe Dokumenteve të tenderit (Request for Proposal) të miratuara nga FSHZH.

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikim urban, restaurim në fshatin e Dhërmiut, Bashkia Himarë”, ka ka kualifikuar me mangësi në dokumentacion JV “R.” sh.p.k & “Gj.” sh.p.k , në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB, Shtator 2011, Direktivës së Prokurimeve 2014/24/EU dhe Procedurave dhe Guidave Praktike për Prokurimet (PRAG -15.01.2016)dhe Dokumenteve të tenderit (Request for Proposal) të miratuara nga FSHZH.

2. z.A. P., me detyrë specialist në Njësinë e Prokurimit, pasi:

-në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbime supervizimi për punimet civile për rikualifikimet urbane në Vlorë (faza e parë), Himarë (faza e parë) dhe

Bashkinë Pukë”, ka kualifikuar JV “T.” sh.p.k & “E.G” sh.p.k me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB, Shtator 2011, Direktivës së Prokurimeve 2014/24/EU dhe Procedurave dhe Guidave Praktike për

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikim urban, restaurim në fshatin e Dhërmiut, Bashkia Himarë”, ka kualifikuar padrejtësisht JV “R.” sh.p.k & “Gj.” sh.p.k , në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB, Shtator 2011, Direktivës së Prokurimeve 2014/24/EU dhe Procedurave dhe Guidave Praktike për Prokurimet (PRAG -15.01.2016) dhe Dokumenteve të tenderit (Request for Proposal) të miratuara nga FSHZH.

Prokurimet (PRAG -15.01.2016)dhe Dokumenteve të tenderit (Request for Proposal) të miratuara nga FSHZH.

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikim urban i zonës bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, ka skualifikuar padrejtësisht ofertuesin “G.” sh.p.k dhe ka kualifikuar me mangësi në dokumentacion JV “Gj.” sh.p.k & “R.” sh.p.k & “A.” sh.p.k, në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB, Shtator 2011, Direktivës së Prokurimeve 2014/24/EU dhe Procedurave dhe Guidave Praktike për Prokurimet (PRAG -15.01.2016)dhe Dokumenteve të tenderit (Request for Proposal) të miratuara nga FSHZH.

3- z. D. M., me detyrë specialist i Njësisë së Projekteve të Infrastrukturës Rrugore, pasi:

-në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbime supervizimi për punimet civile për rikualifikimet urbane në Vlorë (faza e parë), Himarë (faza e parë) dhe Bashkinë Pukë”, ka kualifikuar JV “T.” sh.p.k & “E.G” sh.p.k me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB, Shtator 2011, Direktivës së Prokurimeve 2014/24/EU dhe Procedurave dhe Guidave Praktike për

-në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbime supervizimi për punimet civile në zonën bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, ka kualifikuar JV “T.” sh.p.k & “E.G” sh.p.k me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB, Shtator 2011, Direktivës së Prokurimeve 2014/24/EU dhe Procedurave dhe Guidave Praktike për Prokurimet (PRAG -15.01.2016)dhe Dokumenteve të tenderit (Request for Proposal) të miratuara nga FSHZH.

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikim urban, restaurim në fshatin e Dhërmiut, Bashkia Himarë”, ka kualifikuar me mangësi në dokumentacion JV “R.” sh.p.k & “Gj.” sh.p.k , në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB, Shtator 2011, Direktivës së Prokurimeve 2014/24/EU dhe Procedurave dhe Guidave Praktike për Prokurimet (PRAG -15.01.2016) dhe Dokumenteve të tenderit (Request for Proposal) të miratuara nga FSHZH.

Prokurimet (PRAG -15.01.2016) dhe Dokumenteve të tenderit (Request for Proposal) të miratuara nga FSHZH.

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikim urban i zonës bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, ka skualifikuar padrejtësisht ofertuesin “G.” sh.p.k dhe ka kualifikuar me mangësi në dokumentacion JV “Gj.” sh.p.k & “R.” sh.p.k & “A.” sh.p.k, në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB, Shtator 2011, Direktivës së Prokurimeve 2014/24/EU dhe Procedurave dhe Guidave Praktike për Prokurimet (PRAG -15.01.2016)dhe Dokumenteve të tenderit (Request for Proposal) të miratuara nga FSHZH.

4- z.D. Th., me detyrë specialist në Njësine e Prokurimit, pasi:

-në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbime supervizimi për punimet civile në zonën bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi, Bashkia Himarë”, ka kualifikuar JV “T.” sh.p.k & “E. G” sh.p.k me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me Udhëzuesin e Prokurimit të CEB, Shtator 2011, Direktivës së Prokurimeve 2014/24/EU dhe Procedurave dhe Guidave Praktike për Prokurimet (PRAG -15.01.2016)dhe Dokumenteve të tenderit (Request for Proposal) të miratuara nga FSHZH.

5- z.M. Xh., me detyrë specialist i Njesisë së Projekteve të Infrastrukturës Rrugore, pasi:

- në cilësinë e menaxherit të kontratës, Nr.CWPIV/W/OP/2016/1 “Rikualifikim Urban në Bashkinë e Vlorës, Faza e Parë” ka lejuar realizimin punimeve jo sipas specifikimeve të preventivit të kontratës, të gjelbërimit, sinjalistikës, ndriçimit etje, dhe moskryerjen e punimeve me vlerë **1,423,275.4 pa tvsh**, një pjesë të të cilave mund të konstatoheshin nga sondazhe vizive si të pakryera.

- Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të IT dhe Projekteve të Huaja dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R